



Piku i naftës rrezikon seriozisht të ardhmen

Edvin Pacara

04/03/2010

Nëse më parë ata që jepnin alarmin për afrimin e pikut të naftës ishin një grup ekonomistësh dhe financierësh, tani janë kompani të mëdha ndërkombëtare të naftës si Total, Petrobras, apo kompani të mëdha britanike si Virgin, Scottish, Southern, Stagecoach po u bien kambanave për rrezikun e rëndë që u kanoset ekonomive që janë të varura tërësisht nga nafta.

Çfarë është piku i naftës? Është pika maksimale e nxjerrjes së naftës, përtej së cilës prodhimi bie në mënyrë të pakthyeshme. Shumë persona do të thonë “Po sikur kishim naftë është për 40 vjet të tjera, si ka mundësi që nafta po mbaron?” Kjo mund të jetë e vërtetë, megjithëse shumë nga raportimet e OPEC-ut për rezervat e naftës përmbanin fryrje shifrash dhe gabime në matje dhe vlerësime me realiste tregojnë se rezervat e naftës mund të zgjasin edhe për 20 vjet të tjera me këtë ritëm rritjeje të kërkesës për naftë në botë. Piku i nxjerrjes së naftës, përkon me pikën ku mbi 50% e naftës është harxhuar. Pas kalimit të kësaj pike, sasia e naftës së nxjerrë bie, ndërsa kostoja e naftës rritet me shpejtësi të madhe. Ajo që do ta përshpejtojë më tej arritjen e pikut të naftës, është kërkesa gjithnjë e në rritje për naftë—më shumë se 1400 makina i shtohen rrugëve të Kinës çdo ditë. Ndërsa nxjerrja e naftës do të arrijë pikun e saj, kërkesa do të vazhdojë të rritet pa u ndalur, duke sjellë rritjen e pandalshme të çmimit të naftës e nënprodukteve të saj. Sipas Robert Duncan, bota ka arritur pikun e nxjerrjes së naftës në vitin 2010, ose do ta arrijë atë në 2-3 vitet pas 2010. Lind pyetja, pse nuk po ndihet rënia e prodhimit të naftës apo rritja e madhe e çmimit? Përgjigjja është: Sepse kriza financiare e 2008-2009 uli ndjeshëm rritjen ekonomike botërore duke ulur kështu dhe kërkesën për naftë dhe duke e shtyrë arritjen e pikut të naftës edhe për 3 vjet tjera. Task-forca britanike e industrisë, mbi sigurinë energjetike dhe naftën, raportoi në shkurt të këtij viti se duke u bazuar në kapacitetet botërore të nxjerrjes së naftës dhe faktorët që ndikojnë në konsumin e saj, prodhimi global i naftës do të arrijë pikun në 2013, dhe pastaj do të fillojë të bjerë nga viti 2015, ndërsa konsumi e kërkesa do të rriten. Kjo do të thotë që rritja e çmimit të naftës do të fillojë të ndihet duke filluar nga viti 2013.

A duhet që Shqipëria si shtet e shoqëri të shqetësohet për këtë? Duhet të shqetësohet shumë dhe të fillojë sa më shpejt marrjen e masave zbutëse. Nga njëra anë rënia e sasisë së naftës në dispozicion do të jetë një gjë e mirë për mjedisin dhe shëndetin publik, sepse do të thotë më pak naftë e djegur në qytete ku shkakton dhe dëmin më të madh dhe më pak emetime karboni, por nga ana tjetër do të thotë katastrofë për ekonominë, me efekte të rënda për ekonominë e vendit. Kriza e naftës do të kapë të gjitha ekonominë botërore, por ato që do të vuajnë më tepër janë ekonominë e vendeve që janë krejtësisht të varura nga nafta, janë ekonomi të dobëta dhe nuk kanë

asnjë mundësi për të riorientuar ekonomitë e tyre drejt ekonomive të burimeve të rinovueshme, vende ku futet dhe Shqipëria. Në vend që ekonomia shqiptare të largohet sa më shpejt nga varësia ndaj naftës, ajo po orientohet krejtësisht drejt naftës dhe burimeve të tjera fosile ndotëse. Është e pafalshme për një vend si Shqipëria, me burime të shumta të rinovueshme, të drejtojë ekonominë e saj drejt naftës. Jemi një vend që ka diversitet energjish të rinovueshme, si energjia diellore, e erës, hidrike, gjeotermale, e biomasës etj. Por në vend që të fillojë shfrytëzimin e këtyre energjive, Shqipëria po hedh të gjitha investimet e saj në energji fosile që nuk do të jenë në dispozicionin tonë për një kohë të gjatë dhe do dëmtojnë shëndetin publik. Një shembull i thjeshtë është investimet në linja trenash elektrike. Në vend që ne të shkonim në Durrës më një tren të shpejtë elektrik që nuk do të kishte nevojë për naftë, na duhet të harxhojmë sasi të konsiderueshme naftë për të shkuar nga Tirana në Durrës duke ndotur edhe më shumë një zonë tashmë të ndotur. Duhet t'i bëjmë vetes një pyetje, me çfarë do të shkojmë ne në Durrës a në qytete të tjera të vendi kur të fillojë rritja galopante e çmimit të naftës? Si do të funksionojë ekonomia shqiptare pas arritjes së pikut të naftës dhe rritjes së papërballueshme të çmimit të saj? Pasojat afatshkurtra do të jenë të rënda. Duke qenë se deri tani nuk ka asnjë strategji apo masë të marrë për këtë gjë, kjo krizë do ta gjejë Shqipërinë krejt të papërgatitur. Sektori i parë që do të goditet do të jetë transporti, i cili tani për tani varet krejtësisht nga nafta. Ndërsa vendet perëndimore kanë investuar shumë në transportin me trena elektrike, vendi ynë nuk asnjë investim në këtë sektor. Kriza që do të përfshijë transportin do të reflektohet direkt në ekonominë e vendit. Do të preken sektorët e shpërndarjes, shërbimet, prodhimi etj.

Siç e thashë dhe më lart, vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim do të jenë ato që do të vuajnë më shumë këtë krizë. Kjo vjen si pasojë e një sërë faktorësh: vendet e zhvilluara kanë më tepër kapital dhe teknologji për të riorientuar ekonomitë e tyre për një kohë relativisht të shkurtër drejt një ekonomie që përdor energji të rinovueshme, ato një forcë punëtorë të aftë për të bërë këtë kalim, ato kanë aftësitë sociale dhe administrative për ta bërë një gjë të tillë, dhe ato kanë aftësitë ekonomike për të zbutur pasojat e krizës në fillimet e saj. Vende si Suedia, Islanda, Irlanda dhe Kosta Rika kanë hartuar strategji dhe kanë ndërmarrë hapat e para për të zbutur efektet e krizës së pritshme të naftës, dhe kanë filluar me transformimin e ekonomive të tyre drejt ekonomive të gjelbra që nuk varen nga nafta dhe hidrokarburet fosile. Izraeli, Danimarka dhe Australia, nëpërmjet kompanisë vizionare "Better Place", po instalojnë pikat e furnizimit me energji elektrike të makinave elektrike që këtë vit dolën pasivisht në treg. Shtete të tjera perëndimore po bëjnë riplanifikimin e qyteteve në mënyrë që të nevojitet sa më pak transport, po investojnë masivisht në transportin publik, po instalojnë sisteme të kapjes së ujit të shiut dhe po futin konceptin e kultivimit urban e lokal të drithërave, frutave e perimeve për të ulur sa më shumë distancën ndërmjet konsumatorit dhe vendit ku prodhohet ushqimi. Shqipëria duhet të fillojë sa më shpejtë marrjen e masave për të përballuar situatën që do të krijohet nga piku i naftës. Nëse shëndeti i shqiptarëve nuk është marrë parasysh si një faktor për të ndërhyrë në minimizimin e përdorimit të naftës dhe futjes së energjive të rinovueshme, kriza ekonomike që piku i naftës sjell duhet të shtyjë Shqipërinë të ndërmarrë masa për zbutur kalimin nga ekonomia e bazuar në naftë në atë në energji të rinovueshme. Një kalim i tillë duhet bërë tani, pasi është një realitet që nuk mund ta injorojmë.